**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "CONSERVALBA TRANSPORT&LOGISTICS" SH.P.K**

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe në ligjin nr.9723 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, sot me datë 23.02.2022 me vullnetin tonë të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt- themelimi ne ortakët:

a) Mirela Çipi, shtetase shqiptare, me numër personal identifikimi G95219045K, i datëlindjes 19.02.1969, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

b) Etrit Haznedari, shtetas shqiptar, me numër personal identifikimi G80113049V, i datëlindjes 13.01.1968, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

c)Mariana Cipi, shtetase shqiptare,me numer personal identifikimi G55531127U, e ditlindjes 31.05.1965,madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Vendosëm krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "CONSERVALBA TRANSPORT& LOGISTICS " shpk me akt themelimi si vijon:

**Neni 1**

Formohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "CONSERVALBA TRANSPORT& LOGISTICS"

Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.

**Neni 2**
**Selia**

Shoqëria e ka selinë në: Rruga "Agostin Serreqi", Godina 565, Hyrja 1, Ap.1.

Zona kadastrale. 8514 Nr pasurise 1/103+1-1, Durres

Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 3**

**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Transport me mjete te te treteve. Import eksport, bashkepunim dhe kooperim me shoqerite tregtare brenda dhe jashte vendit.

**Neni 4**
**Kohëzgjatja**

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një afat të pakufizuar në kohë.

## Neni 5
## Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë dhe është i ndarë në 3 (tre) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortaku themelues Mirela Çipi , zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 33 (tridhjetë e tre mijë) Lekë, që përben 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku themelues Etrit Haznedari , zotërues i 1 (një) kuote kuote me vlerë të përgjithshme 33 (tridhjetë e katër mijë) Lekë, që përben 34% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku themelues Mariana Cipi zoterues I nje kuote me vlere te pergjithshme 33 (tridhjetë e tre mijë)Leke qe perben 33% të kapitalit themelor të shoqerisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

## Neni 6
## Drejtimi Shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga administratorët e saj. Ato do të jenë përfaqësuesit e shoqërisë me marrdhënie me të tretët dhe kanë kompetenca të plota në drejtimin e saj.

Administratori i shoqërisë emërohet Etrit Haznedari, me numër personal identifikimi G80113049V, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

## Neni 7

Ortakët themelues kanë të drejtë të emërojnë administrator tjerë të vlerave materiale dhe kanë të drejtë të caktojnë financier, likuidator për problemet e shoqërisë.

## Neni 8
## Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

## Neni 9

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

## Neni 10

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe legjislacionit shqiptar në fuqi, si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare për biznesin që kryen kjo shoqëri.

## Neni 11

Akti i themelimit u përpilua në 4 kopje, për ta shpërndarë pranë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "CONSEVRALBA TRANSPORT&LOGISTICS" SH.P.K

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët.

**Mirela Çipi**

**(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)**

**Etrit Haznedari**

**(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)**

**Mariana Cipi**

**(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)**

Durrës, datë 23.02.2022